

Kontakt i studimit (Angli): 0800 085 6807

Kontakt i studimit (Uells): 0800 917 9323

Kontakt i studimit (Irlanda e Veriut): 0800 917 5825

Kontakt i studimit (Skoci): 0800 917 5824

## Anketa e Infeksionit COVID-19

Merrni pjesë në anketën më të madhe në mbarë vendin të infeksioneve COVID-19. **Mbështetja juaj do të ndihmojë në orientimin e reagimit ndaj kësaj pandemie dhe kthimin në jetën normale.**



### Për çfarë është anketa?

- Qëllimi i sondazhit është për të gjetur se sa njerëz kanë COVID-19, me ose pa simptoma.
- Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi më shumë njerëz fillojnë të vaksinohen kundër COVID-19 dhe ne fillojmë të monitorojmë se sa mirë funksionojnë vaksinat në botën reale.
- Që nga prilli i vitit 2020, Zyra për Statistikat Kombëtare dhe Universiteti i Oksfordit kanë kryer studimin në emër të Qeverive të MB.



## Pse duhet të marr pjesë?

- Për të ndihmuar luftën e vazhdueshme kundër COVID-19 ne kemi nevojë për familje si tuajat për t'u bashkuar me mijëra që tashmë marrin pjesë në Anketimin e Infeksionit COVID-19.
- Përfshirja juaj në këtë studim do të na ndihmojë të ndërtojmë një pamje të infeksioneve COVID-19 në zonën tuaj. Kjo do të bëjë që autoritetet lokale të veprojnë në mënyrë të përshtatshme dhe efektive.
- Ne nuk po testojmë vetëm ata që kanë shenja të prekjes nga virusi, si ethe ose kollë, sepse e dimë që ndonjëherë njerëzit mund ta marrin virusin pa simptoma.
- Pjesëmarrja në këtë studim është zgjedhja juaj. Të gjitha informacionet që na jepni, mbrohen me ligj dhe trajtohen si konfidenciale.
- Të gjithë në sondazh mund të marrin një vaksinë COVID-19 kur kanë të drejtë ta bëjnë - dhe ata që kanë marrë një vaksinë COVID-19, mund të jenë në sondazh.

## Çfarë përfshin studimi?

- Një anëtar i ekipit të sondazhit do të vijë në shtëpinë tuaj dhe do të bëjë disa pyetje në lidhje me secilin person mbi moshën 2 vjeç që dëshiron të marrë pjesë.
- Ata do t'u tregojnë atyre që janë mbi 12 vjeç si të marrin vetë tamponin e fytit dhe hundës. Ne do t'u kërkojmë prindërve ose kujdestarëve që të marrin tamponin nga fëmijët e moshës 2-11 vjeç. Tamponi është një sfungjer i butë në një shkop dhe nuk lëndon.
- Anëtari i ekipit të studimit nuk do të hyjë në shtëpinë tuaj dhe do të sjellë pajisje mbrojtëse personale dhe do të ruajë distancën shoqërore.




### Ju mund të bini dakord për:

- A** vetëm një vizitë
- B** vizitën e parë dhe vizita çdo javë për një muaj (5 vizita gjithsej)
- C** vizitën e parë, një vizitë çdo javë për një muaj, dhe më pas vizita mujore deri në përfundimin e studimit (të paktën 6 vizita gjithsej). Për momentin, studimi do të zgjasë deri në prill 2022. Ne do t'ju njoftojmë nëse kjo ndryshon.

**▶** Për të parë një video që tregon se si të marrësh një tampon, shiko [www.ndm.ox.ac.uk/covid-19/covid-19-infection-survey/video-guides](http://www.ndm.ox.ac.uk/covid-19/covid-19-infection-survey/video-guides)

# Si mund të marr pjesë?

Për të marrë pjesë do të duhet **të regjistroheni me ne sa më shpejt të jetë e mundur:**

- 1** Telefononi ekipin e regjistrimit në **0800 085 6807 (Angli), 0800 917 9323 (Uells), 0800 917 5825 (Irlanda e Veriut), 0800 917 5824 (Skoci)**. Nëse nuk jeni në gjendje të përdorni telefonin, për shembull për shkak se për shkak të problemeve të dëgjimit ose të folurit, mund të dërgoni email **iqvia.covid19survey@nhs.net** 
- 2** Pasi të jeni regjistruar, hera tjetër që do të dëgjoni nga ne është kur **një anëtar i ekipit të sondazhit t'ju kontaktojë** mbrëmjen para vizitës së planifikuar te ju.  
Nëse kjo kohë nuk është e përshtatshme për ju, mund ta ndryshoni. Ne do të përpiqemi t'ju kontaktojmë brenda javës pasi të regjistroheni. 
- 3** Ditën e takimit, **një anëtar i ekipit të studimit do të mbërrijë në shtëpinë tuaj** për të kryer vizitën. Anëtari i ekipit të anketës nuk do të ketë nevojë të hyjë në shtëpinë tuaj. 

## Çfarë përfitoj nëse marr pjesë?

- Çdo person që merr pjesë në sondazh do të marrë një kupon £50 për vizitën e parë që kryen.
- Për çdo vizitë të mëtejshme që ata kryejnë, secili do të marrë një kupon £25.
- i** Kuponat do të jepen vetëm për vizitat që janë përfunduar. Nëse sondazhi ndalet, ose nëse vendosni të tërhiqeni, nuk do të merrni kupona për vizita që nuk kryhen.

## Çfarë do të ndodhë me të dhënat e mia?

- Çdo informacion që na jepni mbrohet me ligj dhe trajtohet si konfidencial.
- Të gjithë mostrat mblidhen në emër të Zyrës për Statistikat Kombëtare dhe Universitetit të Oksfordit.
- I gjithë testimi i këtyre mostrave bëhet nga Universiteti i Oksfordit dhe Laboratorët kombëtarë Lighthouse.
- Do t'ju thuhet rezultatet e të gjitha testeve që keni përfunduar.

- Kompanitë e përfshira në drejtimin e sondazhit do të përdorin informacionin tuaj vetëm për qëllimin e këtij sondazhi - ju lutemi shikoni Fletën e Informacionit të Pjesëmarrësit për detaje të plota në lidhje me atë që do të ndodhë me të dhënat tuaja.
- Rezultatet po shkëmbehen tashmë, në mënyrë që të gjithë të dinë se çfarë po gjejmë ([www.ndm.ox.ac.uk/covid-19/covid-19-infection-survey/results](http://www.ndm.ox.ac.uk/covid-19/covid-19-infection-survey/results)). Asnjë nga këto informacione nuk ju identifikon ju apo familjen tuaj.

## Informacione të mëtejshme dhe faqe interneti të dobishme:

- ▶ Për të parë një video që tregon se si të marrësh një tampon, shiko [www.ndm.ox.ac.uk/covid-19/covid-19-infection-survey/video-guides](http://www.ndm.ox.ac.uk/covid-19/covid-19-infection-survey/video-guides)

Disa përkthime të kësaj përmbledhjeje dhe informacione të tjera të sondazhit janë në dispozicion në [www.ons.gov.uk/cis/languages](http://www.ons.gov.uk/cis/languages)

Për të mësuar më shumë, shihni fletën me informacion të hollësishëm për pjesëmarrësin, e cila erdhi me këtë broshurë ose vizitoni [www.ons.gov.uk/cis](http://www.ons.gov.uk/cis)

**Nëse prekeni nga ndonjë prej çështjeve të ngritura në këtë broshurë, ose jeni duke kërkuar informacion mbi COVID-19, ju lutemi vizitoni:**

- Koronavirusi i shpjeguar: [coronavirusexplained.ukri.org/en/](http://coronavirusexplained.ukri.org/en/)
- Udhëzimet e qeverisë: [www.gov.uk/coronavirus](http://www.gov.uk/coronavirus) (Angli), [www.gov.wales/coronavirus](http://www.gov.wales/coronavirus) (Uells), [www.nidirect.gov.uk/campaigns/coronavirus-covid-19](http://www.nidirect.gov.uk/campaigns/coronavirus-covid-19) (Irlanda e Veriut), [www.gov.scot/collections/coronavirus-covid-19-guidance/](http://www.gov.scot/collections/coronavirus-covid-19-guidance/) (Skoci)
- Këshilla nga NHS: [www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/](http://www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/) (Angli), [www.gov.wales/coronavirus](http://www.gov.wales/coronavirus) (Uells), [www.nidirect.gov.uk/articles/coronavirus-covid-19-overview-and-advice](http://www.nidirect.gov.uk/articles/coronavirus-covid-19-overview-and-advice) (Irlanda e Veriut), [www.nhsinform.scot/illnesses-and-conditions/infections-and-poisoning/coronavirus-covid-19](http://www.nhsinform.scot/illnesses-and-conditions/infections-and-poisoning/coronavirus-covid-19) (Skoci)
- Samaritans - Mbështetje emocionale për të gjithë: [www.samaritans.org](http://www.samaritans.org)
- Mind - Këshilla dhe mbështetje për këdo që ka një problem të shëndetit mendor: [www.mind.org.uk](http://www.mind.org.uk)